



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 218, Datë 30.09.2025

MBI

**NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 217, DATË 20.12.2019,
“MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “ELVA 2001” SH.A., NË VEPRIMTARINË E
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “MIVAS”, ME KAPACITET
TË INSTALUAR 1940 KW” I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 30.09.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2524 prot., datë 26.09.2025, të Drejtorisë së Politikave të Burimeve të Rinovueshme, “Mbi disa ndryshime në vendimmarrjet e Bordit të ERE-s lidhur me plotësimin e kushteve nga subjektet e licencuar në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike.”,

Konstatoi se:

1. Të dhëna mbi shoqërinë “ELVA 2001” sh.a.

- Me vendimin nr. 217, datë 20.12.2019, i ndryshuar me vendimin nr. 13, datë 29.01.2024, Bordi i ERE-s ka licencuar shoqërinë “ELVA 2001” sh.a. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Mivas”, me kapacitet të instaluar 1940 kW, për një afat 30-vjeçar.
- Në vendimin nr. 217/2019, i ndryshuar, në pikën 2 është përcaktuar se: “Shoqëria ‘ELVA 2001’ sh.a. duhet të depozitojë në ERE: a) Kontratën e rinovuar të qirasë me Bashkinë Gramsh brenda datës 25.03.2029, ose Certifikatën e Lëshuar nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK), që rregullon të drejtën e përdorimit të pronës në zonë ku shtrihet centrali i prodhimit të energjisë elektrike. b) Kontratën e rinovuar të qirasë me Bashkinë Skrapar brenda datës 16.07.2026, ose Certifikatën e Lëshuar nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK), që rregullon të drejtën e përdorimit të pronës në zonë ku shtrihet centrali i prodhimit të energjisë elektrike.

2. Analiza Ligjore dhe Vlerësimi

- Pas ndryshimeve të miratuara me vendimin e bordit të ERE nr. 220, datë 01.09.2022, në Rregulloren “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, është riformatuar neni 9 i rregullores “Formati dhe dokumentacioni për aplikim”, duke shfuqizuar gërmën “g” të pikës 2 të këtij neni, e cila përcaktonte se në dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor të paraqitur për

aplikim përfshihen dhe dokumentet që vërtetojnë pronësinë e aplikuesit në zonat ku do të shtrihet projekti (kontrata shitblerje, kontrata qiramarrje, akte dhurimi, kontrata premtim shitblerje, marrëveshje me subjekte që kanë në pronësi zonat ku shtrihet projekti për ato veprimtari që përdorin asete për kryerjen e aktivitetit të licencuar).

- Në këto kushte, kushti i përcaktuar në pikën 2 të vendimit nr. 217/2019, i ndryshuar, nuk është më i detyrueshëm si pjesë e licencës.
- Në përputhje me nenin 113 të ligjit nr. 44/2015, vlerësohet se pika 2 e vendimit nr. 217/2019 i ndryshuar duhet të shfuqizohet, pasi nuk gjen më mbështetje në kuadrin rregullator, duke lënë të pandryshuara dispozitat e tjera të këtij vendimi.

3. Nevoja për Ndryshimin e Vendimit

- Në mbështetje të nenit 113 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon se një akt administrativ mund të shfuqizohet nga organi publik që ka kompetencën për ta nxjerrë, vlerësohet se pika 2 e vendimit të bordit të ERE-s nr. 217, datë 20.12.2019, i ndryshuar, duhet të shfuqizohet, pasi pas ndryshimeve të miratuara me vendimin e bordit të ERE-s nr. 220, datë 01.09.2022, detyrimi për depozitim e dokumentacionit pronësor të rinovuar nuk është më i parashikuar si kusht në licencë dhe për rrjedhojë, nuk ka më bazë rregullatore për t’u mbajtur në fuqi ndaj shoqërisë “ELVA 2001” sh.a.
- Shfuqizimi i pikës 2 është i nevojshëm për të harmonizuar vendimin nr. 217/2019, i ndryshuar me kuadrin e përditësuar rregullator, duke siguruar qartësi dhe koherencë në kushtet e licencës së shoqërisë “ELVA 2001” sh.a.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Pika 2 e vendimit të bordit të ERE-s nr. 217, datë 20.12.2019, i ndryshuar, shfuqizohet.
2. Heqja e kushteve nuk përjashton këtë shoqëri nga detyrimi për të ruajtur në vazhdimësi të drejtën e ligjshme të përdorimit të territorit ku shtrihet veprimtaria e licencuar, në përputhje me kontratat përkatëse ose aktet e pronësisë.
3. Drejtoria e Politikave të Burimeve të Rinovueshme, të njoftojë shoqërinë “ELVA 2001” sh.a., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, FTL sh.a., dhe OSSH sh.a. lidhur me vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI